



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0346**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga, Agon Ramadani –Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Bereqeti-ING” me seli në Drenas, si dhe ankesën e OE“Eko Term” SH.P.K.,me seli në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave ne Komunën e Prishtinës" me nr.prok 616-22-11826-5-2-1, iniciuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 04.09.2023, morri:

### **Vendim**

1.Hudhet si e palejuar, ankesa e datës 04.06.2023, e OE “Bereqeti-ING”, (Nr.343/23), si dhe Aprovohet pjesërisht ankesa e datës 05.06.2023, e OE "Eko Term" SH.P.K., (Nr.346/23), e parashtruar kundër Vendimit të AK për dhënie të kontratës të datës 19.05.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i varrezave dhe hapësirave ne Komunën e Prishtinës" me nr.prok 616-22-11826-5-2-1, kurse Vendimi i cituar si më sipër i AK anulohet ndërsa lënda kthehet në rivlerësim.

2.Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3.Lejohet OE-ve ankues, “Eko Term” sh.p.k. si dhe “Bereqeti-ING”, kthimi i mjeteve të deponuara në emër të tarifës për sigurim të ankesës, konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Kurse, ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me datën 07.11.2022, AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës, ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 30.11.2022. Me 24.05.2023, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me 19.05.2023, ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i varrezave dhe hapësirave në Komunën e Prishtinës, me nr.prok 616-22-11826-5-2-1, ku është rekomanduar për kontratë OE “Muhamet Muçiqi”.

Me datë 22.05.2023, OE ankues “Bereqeti-ING”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me datë 25.05.2023, AK-Komunës së Prishtinës, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 19.05.2023.

Me datë 24.05.2023, OE ankues “Eko Term” sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-Komunës së Prishtinës, të cilën me datë 26.05.2023, AK e ka refuzuar si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 19.05.2023.

Me datën 04.06.2023 OE ankues “Bereqeti-ING”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 343/2023, kundër njoftimit mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Me datën 05.06.2023 OE ankues “Eko Term” sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 346/2023, kundër njoftimit mbi vendimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Elementet qenësore të këtij aktiviteti të prokurimit konsistojnë si në vijim: Lidhur me këtë të aktivitet të prokurimit AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: lloji i kontratës furnizim, vlera e parashikuar 135.000 €.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK Kuvendi i Komunës së Prishtinës lidhur me raportin Nr/343/23, me 23.06.2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa lidhur me ekspertizën e ekspertit Nr.346/23, me 26.07.2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues. Operatori ekonomik “Bereqeti-ING”, me 27.06.2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me raportin e ekspertit, ndërsa OE “Eko Term” sh.p.k., me 26.06.2023, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit.

*-Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 dhe 114, të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër i cili me 19.06.2023 dhe 22.06.2023, ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Ankesa e datës 04.06.2023, e OE “Bereqeti-ING”, konsiderohet si çështje e gjykuar (res judicata).

Të aprovet si e bazuar ankesa e OE ankues “Eko Term” sh.p.k., me seli në Suharekë,

Të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK të datës 19.05.2023 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim,(*njoftimi për dhënie të kontratës*).

*-Seanca dëgjimore-*

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësit e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE Ankues “Bereqeti-ING”.

Pretendimi nr.1

Pretendimi ankimore se AK ka kushtëzuar me formën e pranimi dokumenteve nga OE ofertues është pa bazuar sepse ofrimi i materialit mbështetës nga dosja e tenderit mund të bëhet (CD,usb,hard-kopje apo server përkatës).

Kërkimi i mostrave është e drejtë ligjore nga AK, por pretendimi juaj rreth mostrave të dorëzuara nga OE ofertues të cilët nuk janë sipas specifikimit teknik dhe paramases nuk mund të jap vlerësimin tim sepse nuk keni paraqitur fakte të mjaftueshme se në çka konkretisht çalojnë mostrat e tyre (d.m.th. cilat dimensione nga mostrat e ofruar nuk janë në proporcion me kërkesat e paramases).

Bazuar në këto që u cekën më lart, pretendimet ankimore janë të pa bazuara.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE Ankues “Eko Term” sh.p.k.

Pretendimi nr.1

Eksperti teknik kam analizuar vendimi nr.34-23 të lëshuar nga OSHP dhe përmbajtja ka të bëjë me një tjetër pretendim ankimore dhe unë si eksperte teknike nuk jam kompetente për trajtimin e tij.

Pretendimi ankimor nga OE ankues se OE fitues nuk e ka dorëzuar dëshminë e kërkuar për Ekskavator, në edhe pas pranimi të sqarimeve nga AK nuk kemi hasur në dëshmi sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Sipas sqarimeve të ofruara nga AK, operatori ekonomik i rekomanduar ka ofruar transaksion bankar për blerje të një ekskavatori, mirëpo i njëjti nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Ekspertja teknike konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi nr.2

Sa i përket pretendimit ankimor se OE ankues ka prezantuar kontratë të vitit 2010 me znj. Mirevete Demiri, mirëpo me dëshmi të ATK e njëjta figuron në listën e OE vetëm nga viti 2022 dhe se me këtë OE i rekomanduar ka bërë mashtrim dhe se kontrata është fiktive, eksperti shqyrtues sqaron se nuk kemi autorizim e as kapacitet për trajtimin e pretendimeve të tilla ankimor, dhe OE ankues për këto pretendime ankimore mund të drejtohet organeve kompetente.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që OE “Bereqeti- ING, të trajtohet si çështje e gjykuar sipas vendimeve paraprake të OSHP-së, ndërsa ankesa e OE ankues “Eko Term” SH.P.K., të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

### *-Konstatimet e panelit shqyrtues-*

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme në mënyrë të pjesërishme nga ana e këtij paneli, për faktin se në këto raporte është konsideruar se nuk përmbajnë argumente, të gjetura dhe rekomandime të qarta, andaj është arritur deri tek vendim-marrja përfundimtare që aktiviteti kthehet në rivlerësim dhe i njëjti të zhvillohet në relacion me pretendimet e paraqitura dhe vërtetimin e të njëjtave.

Lidhur me ankesën me nr 343/23 si, PSH konstaton se nuk pajtohet me të gjeturat dhe rekomandimet e ekspertëve të cilët kanë rekomanduar që çështja të trajtohet si res-judicata apo si çështje e gjykuar (343/23), për faktin se në vendimin paraprak objekt shqyrtimi ka qenë arsyeja e paraqitur e AK-së ndaj anulimit të tërësishëm të aktivitetit, ndërsa në rastin konkret, ankesa e OE ankues konsiston në faktin se OE i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesat e DT, ndërsa vlen të theksohet se deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi është arritur duke u nisur nga fakti që në njoftimin mbi vendimin e AK-së lidhur me aktivitetin konkret OE ankues për nga çmimi është radhitur si i treti, ndërsa në ankesën e tij ka ngritur pretendime vetëm kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, duke anashkaluar OE me çmim më të lirë të klasifikuar si të pasuksesshëm nga ana e AK-së përmes këtij vendimi, andaj rrjedhimisht edhe pse paneli vlerëson se kërkesa për rishqyrtim nuk i ka plotësuar kushtet e parapara të trajtohet si e tillë sepse e njëjta ka pretendime vetëm për OE të shpallur fitues kurse nuk ka pretendime për OE e dytë me radhë i cili është me çmim ma të lirë se OE ankues andaj mbi këtë bazë ankesa bie në kundërshtim me paragrafin 1.26 të nenit 4 dhe paragrafin 1.5 të nenit 111 të LPP-së, si dhe e njëjta bie në kundërshtim edhe me Njoftimin për Operatorët Ekonomik të publikuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik në web-faqen e OSHP-së me datë 09.02.2023, Paneli shqyrtues sqaron se për tu trajtuar si palë me interes OE ankues duhet plotësuar dy kushte të dëshmoje se është i përgjegjshëm oferta e tij dhe të ketë pretendime përveç fituesit edhe për OE tjerë që janë me çmim më të lirë se oferta e OE ankues ,e në rastin konkret OE ankues nuk ka pretendime fare për OE e dytë që është me çmim ma të lirë andaj i njëjti bazuar në ato që u thanë më lart trajtohet si palë pa interes, deri tek kjo mënyrë vendim-marrje poashtu është arritur duke u bazuar në konsistencën e vendimeve të bordit aktual, ku situata të njëjta/ngjashme janë trajtuar në mënyrë të tillë.

Lidhur me ankesën 346/23, pretendimet ankimore qëndrojnë mbi kontestimin e pajisjeve eskavatorit si dhe stafit të paraqitura në ofertën e OE ankues, lidhur me këtë, konform raportit të ekspertëve është evidentuar se në ofertën e tij OE ankues ka paraqitur listën e pajisjeve si dhe transaksionin bankar lidhur me eskavatorin, andaj AK në këtë rast mund të aplikojë nenin 72 për të kërkuar informata sqaruese, ndërsa lidhur me pretendimin mbi stafin e paraqitur, përkatësisht ku OE ankues ka pretenduar se OE i rekomanduar ka paraqitur kontratën e vitit 2010 me

znj.Mirevete Demiri, mirëpo me dëshmi të ATK e njëjta figuron në lista të OE vetëm nga viti 2022, PSH ka evidentuar se kërkesa mbi stafin ka qenë që të sigurohet dëshmi se për stafin e kërkuar duhet të paraqiten: ”a) *Për Inxhinieret apo Beachelor te dorezohet CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.* b) *OE duhet të dorëzoj certifikatat e salduesve kontrata e punës apo Marrëveshja mbi angazhimin e tyre*” ndërsa nuk kërkohet lista e ATK-së apo deklarimi rreth këtyre listave si kërkesë decidive ne DT, AK lidhur me këtë kërkesë mund të aplikojë nenin 59 të LPP-së për vërtetimin e kontratës së paraqitur dhe se pretendimin mbi kontratën, andaj përgjatë procedurës së rivlerësimit AK të vërtetojë pretendimet ankimore të paraqitura në këtë ankesë në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së.

Andaj përfundimisht, duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejtë, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj në detaje ankesën me nr 343/23 për faktin se OE ankues klasifikohet si palë pa interes.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrë në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Prandaj Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Agon Ramadani**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " Eko Term " SH.P.K., BEREQETI - ING**
- Arkivës së OSHP-së: